



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ prot.

Berat , më ____ . ____ .2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

*(Për argumentimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE NDËRTIMI DHE SETE PLLAKASH PËR VARREZAT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Cimento,derrasa,tubo

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.073.516 (një million e e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) Lek pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024 dt 20.03.2024, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 9.**
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 4.**

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar Ofertuesit duhet të paraqesin:

2.2.1 Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5,

datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshetje VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit **Shenim:** Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/ dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

dhe/ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë një kamion me vinxh të integruar në të me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton për transportin e mallrave objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

Për mjetet që shënohen **në regjistra publikë në pronësi**, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Për mjetet që shënohen **në regjistra publikë, me qera**, krahas dokumentacionit si më lart duhet të paraqitet dhe kontrata noteriale e qerasë e vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjetit, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 5, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht (në pronësi ose të siguruara me qira) mjetet e nevojshme për lëvrimin e mallrave të kërkuara nga AK, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Numri dhe lloji i mjeteve (në pronësi ose të siguruara me qira), janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar orëve të punës, dhe afatit të lëvrimin të mallrave objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket mjeteve të kërkuara, gjë për të cilën janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten..

2.3.3 Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalent (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve / furnizimeve / shërbimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vet natyrën e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit, janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë. Pra, nisur edhe nga vetë përcaktimi ligjor, kërkesat e përcaktuara sipas kësaj pike, janë në përputhje dhe harmoni me natyrën dhe përmasat e objektit që prokurohet.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër furnizimin e Autoritetit Kontraktor me mallrat objekt prokurimi me shpenzimet e tij pranë ambienteve të AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK rezervon të drejtën në rast se malli objekt prokurimi, nuk plotëson kërkesat dhe standartet teknike, të mos merret në dorëzim.

Kontrolli lidhur me sasinë, cilësinë dhe elementet e tjerë teknik do të bëhet nga një komision i veçantë i ngritur nga titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) përpara procedurës së marrjes në dorëzim të mallit.

Argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, janë argumentuar nga specialisti i fushës pjesë e njësisë së prokurimit Besjana Kokoshi.

3. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nr	Emertimi I punimit	Njesia	Sasia
A	Materjale ndertimi		
1	Cimento 32.5R	kg	22000
2	Zgara hekuri 6Ø(5*2)	cope	123
3	Kapak Gize75* 75) Per trotuare	Cope	21
	Shuma A		
B	Materiale per sherbime varrimi		
1	Pllaka betoni per ndertimin e varrit anesore 105x55x4 cope 4 (240 cope)	set	60
2	Pllaka betoni për ndërtimin e varrit ballore , permasa cm 55x75x4, cope 2(110 cope)		
3	Pllaka betoni per mbulimin e varrit(kapak), permasa cm 85x45x4, cope 5(275 cope)		
4	Pllaka betoni anesore per konfigurimin e varrit, permasa cm185x25x4, cope2(120 Cope)		

5	Pllaka betoni ballore, me permasa cm90x25x4, cope 2(120 cope)		
6	Pllaka betoni ballore jashte standartit 80x60x4 cop 10		
7	Pllaka betoni per mbulimin e varrit jashte standartit (kapak)90x45x4 cope 25		
8	Koka varri prej llamarine cm20x40, trashesi 0.5mm,	cope	61
	Shuma B		

1.ÇIMENTO 32.5 R

Cimento e zakonshme;

Çimento 32.5R duhet të jenë në përputhje me EN 206-1 dhe EN 197-1. Çimento Portland me shtesa gëlqërore CEM II/B-LL, sipas EN 197-1.

2.ZGARA HEKURI

Hekur Ø 6; kuadrat sipërfaqe 10 m²; permasa 5x2

Perdorimi per shtresa betoni ne rrugeduhet te jete me hekur Ø6 mmdhe me permasa te zgares (5*2)m.si dhe me permasat kuadratike zgares (20*20)cm

3.KAPAK ZGARE GIZE.

Kapak Gize 75* 75, për trotuare. Kapakët të jene prej Gize, te plote ,te qendrushem ndaj peshave te renda dhe rezistent ne perkulje.

4.PLLAKA BETONI PER NDERTIM VARRESH.

Te jene cilesore, te stazhionuara, dhe me perberje hekuri Ø8. Marka e betonit te jete C16/20.

Njesia e Prokurimit:

Roland Deda Personi pergjegjes juristi

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Brikena Halitaj Specialiste ekonomiste

Joana Melengu

Besjana Kokoshi Specialisti i fushës

